



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-34743/2018
Kaçanik, 30.10.2018

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (Dhjetë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Tetor 2018. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë- të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale (Zahir Doda, Fatmir Loku, Ramadush Osmani dhe Bahri Selimi).

Nga zyrtarët komunal ishin: Hamzë Berisha, Menduh Krasniqi, Bajtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtës, Makfirë Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, e lexoj listën e anëtarëve të KK emër për emër, kuorumi ekziston, ndërkaq në vazhdim e hapi mbledhjen e X (Dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2018, data 30 Tetor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullorë për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre;
3. Propozim- Vendim për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës për vitin 2018;
4. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcelën kadastrale Nr. 00587-2, ZK në Kaçanik, Agjenscionit të punësimit të Republikës së Kosovës;
5. Propozim Vendim për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
6. Informatë për përfundimin e vitit shkollor, 2017/2018; dhe
7. Informatë – Përmbledhja e rezultateve për vitin 2017, për Grantin e performancës- Komuna Kaçanik.

Kryesuesi i Kuvendit, Sipas Ftesës për mbledhje në rend pune si pikë e tretë ishte edhe: Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për dhënien me qira të banesave në pronësi të Komunës. Fillimisht për këtë çështje fjalën e ka Kryetari i Komunës, Besim Ilazi.

Kryetari i Komunës Besim Ilazi, Po e marrë fjalën pasi drejtoresha, Diana Reka nuk është prezentë për shkak të disa obligimeve tjera të saja, Çështja e Formimit të komisionit për hartim të Rregulloresve bien në kompetenca të Kryetarit të Komunës, kështu kjo pikë hiqet nga rendi i punës, ndërkaq Ekzekutivit të Komunës i mbetet të merret me këtë çështje, ndërkaq dhënia në shfrytëzim e banesave bëhet nga një Komision i cili do të formohet me vendim të KK.

Kryesuesi i Kuvendit, Pasi që Kryetari i Komunës, Kërkoj që pika e 3-të që ishte sipas ftesës për mbledhje, Propozim-Vendim për formimin e Komisionit për hartimin e Draft-Rregullores për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për dhënien me qira të banesave në pronësi të Komunës me u hequr nga Rendi i propozuar i punës e, shtroj në votim për aprovim rendin e punës, pasi që kjo çështje bie në kompetenca të Kryetarit të Komunës. Rendi i propozuar i punës u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendi i Punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes së 9-të të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri me disa ndërhyrje të cilat i potencoj, z. Ekrem Kyçyku të pika e dytë, të diskutimi i tij dhe Adnan Reka kërkoj të fshihet një pjesë e diskutimit të tij që është përsëritur dy herë në proces. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, e;

APROVOJ

Procesverbalin nga mbledhja e 9 (Nëntë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës të datës 27 Shtator 2018/ Lënda 01Nr. 60/03-31550 /2018.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit, konstatoj me kaluar në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Ekrem Kyçyku, Në Sheshin " Ismail Raka" janë fshirë vendkalimet për këmbësor. A ka mundësi të ri shënohen këto vija të vendkalimeve dhe të bëhet edhe vija përkufizuese e kësaj rruge.

znj. Lirije Luta, Në emër të qytetarëve të f. Ivajë, i kam disa Kërkesa:

1. Kërkoj të vendosën pengesa (policë të shtrirë) në rrugën: Kaçanik- Ivajë dhe vendosja e shenjave në këtë rrugë;
2. Të bëhet rehabilitimi i rrugës së Brigadës 162 “ Agim Bajrami” në afërsi të shkollës së Ivajës,
3. Të bëhet eliminimi i pengesave të krijuara në rrugën: Kaçanik-Ivajë,
4. Të merren veprime të nevojshme për Rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimit të f. Ivajë, për të cilat, projekti veç është dërguar në komunë.

z. Shpend Krusha.

1. Shprehi shqetësimet e tija lidhur me trotuarin e rrugës së f. Begracë, ku një pjesë e trotuarit ka pasur erozion. Me intereson të di, a duhet të mirëmbahen projektet e realizuara të komunës, si është kontrata, a ka garancion komuna për atë projekt;
2. Ne anëtarët e KK kërkoj të pajisemi me, Kartela identifikuese, në mënyrë që me ditur që jemi anëtarë të KK, (Kërkesë kjo e përsëritur edhe me herët nga po i njëjti anëtar);
3. A ka ndonjë përgjigje lidhur me Kërkesën të cilën në emër të Kuvendit të Komunës ia adresuam Ministrisë së Infrastrukturës për çështjen e ndërtimit të një Kycje-Ç kycje në afërsi të qytetit të Kaçanikut, në autostradën” Arbër Xhaferi” Kërkesë kjo e bërë që tre muaj.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkesa e cila më u drejtua mua nga z. Shpend, për pajisjen e anëtarëve të KK me Kartela Identifikuese, kjo është në kompetenca të drejtorisë së Administratës (DAP). Ne do ti përcjellim këtë Kërkesë DAP dhe besoj së e njëjta do të realizohet.

z. Adnan Reka,

1. Çështja kanalizimit të ujërave të zeza në rrugën “Sali Bajra”, kur keni planifikuar ta kryeni këtë punë, apo nuk e dini as ju se kur mund të kryhet apo nuk do të kryhet fare, përgjigjet e tilla nuk mendoj se qytetarët janë të interesuar t’i dëgjojnë.
2. Në mbledhjen e fundit të Kuvendit, unë kërkoja nga Hamiti (si kryesues) që Komiteti për Shërbime Publike(KSHP) të filloj punën, e ju e potencuat se jo vetëm Komiteti për Shërbime Publike, por edhe të gjitha Komitetet dhe Komisionet të tjera duhet të bëhen funksional.

Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale që nga mbledhja e 4 diku në muajin, prill / maj, kur ka kaluar në Kuvend ende nuk është funksionalizuar, për kundër kërkesës sime edhe në mbledhjen e VIII që ky komision të funksionoj. Kush prisni kryesues se duhet të vij t’i bëjë funksionale këto Komisione ?

3. Në shtator të vitit 2017, gjatë fushatës elektorale të këtyre zgjedhjeve, në fshatin Kovacec, gjatë punimeve në autostradën ‘Bechtel Enka’ u kishte shkaktuar një dem të madh tri familjeve në lagjen ‘Burrnik’. si pasojë këto familje ishin detyruar të largohen dhunshëm nga prona e tyre dhe kompania ishte detyruar të lidhë kontratë për pagesën e qerasë së banimit me këto familje, për 6 + 6 muaj. Para një muaji këtyre familjeve u ka skaduar kontrata dhe kompania ka refuzuar t’ua vazhdoj kontratën, dhe me shumë se një muaj ata qëndrojnë ashtu si munden të gjenden vet. Këto familje kishin bërë kërkesë edhe të organet Komunale që Komuna të ndikoj që këto familje të kryqen në ujësjellës dhe rrjet elektrik të cilën e kishte shkëputur kompania. Këtyre tri familjeve as nuk janë shpronësuar pronat e as nuk janë trajtuar nga askush. Para disa ditësh në dëgjuam në media se Kryetari i Hanit të Elezit ua ka ndërprerë punimet ‘Bechtel Enkas’ jo vetëm për demet që po ua shkakton qytetarëve të vet, por bile edhe se po ua prishë qetësinë e natës! Ju çfarë po bëni për qytetarët tuaj që kanë mbetur në atë gjendje, a keni në plan t’ju dilni në ndihmë këtyre familjeve të gjora?

Kryesuesi i Kuvendit, Të gjitha Komitetet dhe komisionet e formuara nga KK i kanë Kryesuesit e tyre dhe ne mund të kërkojmë direkt nga ta arsyet përse nuk janë funksionale Komitetet respektivisht komisionet e KK. Secili komision në fund ka me bërë një Raport pune dhe nëse ne si KK e shohim se ai komisioni nuk ka punuar mirë, atëherë kemi të drejtë me e shkarkuar atë komision dhe me formuar komision me anëtarë tjerë. Nuk është kompetencën time t'iu bëjë presion komisioneve, ata janë zgjedhur nga KK, i kanë kryesuesit e tyre. Çështja e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, sa e di unë, Shoqata Gratë për Gratë e ka stopuar pakëz këtë çështje, duke dashur me bërë një sensibilizim më të madh të komuniteteve që me u përfaqësuar edhe femrat nëpër Këshilla të fshatrave. Megjithatë secili komision e ka kryesuesin e vet dhe të njëjtit janë të obliguar për me i kryer detyrat e tyre për të cilat janë zgjedhur.

z. Adnan Reka, Komisioni për Zgjedhjen e Këshillave të fshatrave Kryesues nuk është thirrur ende asnjëherë që me zgjedhë Kryesuesin e tij. Ky Komision ende nuk ka të zgjedhur Kryesues e tyre, kështu kjo çështje si duket ka mbetur vetëm e shkruar në letër.

znj. Kaltrina Tafili, Në lagjen "Skënderbeu, të Stacioni i Trenit, rruga është bërë e pakalueshme nga veturat e shumta. Kërkesa ime është; Të merr veprime të nevojshme nga organi përkatës për zhbllokimin e rrugës në fjalë nga auto -veturat.

z. Hajredin Luta, Kërkoj nga organi përkatës që të merren veprime të nevojshme për shënjimin e rrugës, Kaçanik-Gajre- Ivajë.

znj. Hafize Sallahu,

1. Shprehi shqetësimet e saja për prerjen e pyjeve në pronësi të komunës, në mënyrë të pamëshirshme. Lidhur me prerjen e pyjeve të komunës theksoj se, kam hasur vet në një rast të tillë në f. Gilloboqicë, ku personat të papërgjegjshëm i presin pyjet në mënyrë të pamëshirshme. Kjo të bënë me kuptuar se personat përgjegjës nuk po i kryejnë punët e veta, ndërkaq në pyjet e komunës është duke u shkaktuar kaos nga prerja dhe dëmtimi i tyre në mënyrë të pamëshirshme.

2. Ambulanta në f. Ivajë është ndërtuar nga donacionet dhe është premtuar se kjo ambulante do të punoj çdo ditë me motër medicinave, dhe 1 herë në javë me mjek. Gjithashtu është premtuar se do t'i bëhet edhe rrethoja, ndërkaq sot e asaj ditë ajo ambulante nuk funksionon. Me intereson të di, përse nuk punon ajo ambulante dhe përse nuk i bëhet rrethoja, kur dihet se në oborrin e saj shëtisin kafshët. Drejtoresha Diana thotë se kjo Ambulante nuk funksionon sepse nuk ka pacientë. Unë shpresoj të mos ketë pacient, por sa unë jam e informuar nga komuniteti, pacientë ka, por ata mjeku i orienton me shkuar në QKMF, ndërkaq dihet se në atë fshat ka persona me sëmundje të ndryshme, ndërkaq dihet largësia dhe shpenzimet e pacientëve për vajtje – ardhje në QKMF, ku për një ditë vetëm për buletë të autobusit pacienti shpenzon 2€, ndërkaq logaritme shpenzimet nëse udhëton pacienti për një javë rresht për injeksione. Pyetja ime është; Përse nuk funksionon ajo ambulante, kur dihet se objekti i plotëson kushtet për punë?

znj. Nazife Krasniqi,

1. Kërkoj që të merren veprime të nevojshme për rregullimin e rrugëve lokale në Kaçanik, ashtu që të gjitha rrugëve në qytet me ua vendosur ka një shtresë asfalti, sepse të njëjtat janë dëmtuar shumë;

2. Kërkoj me u ndërtuar një "Kënd i Lojërave të fëmijëve" në qytet, pasi ekziston mundësia me u bërë të Parku i qytetit në Kaçanik, kur dihet se realizimi i këtij projekti nuk është shumë i kushtueshëm.

z. Bekim Koxha,

1. Kërkesa e parë është për DSHPE për një deponi të krijuar në hyrje të f. Koxhaj. Kërkesa ime është që drejtoria të mundohet me hekë atë deponi, sepse është afër rrugës në njërën anë dhe në anën tjetër është shqetësim për qytetarët e f. Koxhaj;

2. Ku ka arritur projekti Ujësjiellit i cili është duke u ndërtuar për disa fshatra, ku qëndrojnë arsyet që nuk finalizohet ky projekt, kur dihet se banorët e fshatrave; Doganaj, Dubravë, Elezaj etj. nuk kanë ujë të pijes.

3. Të shkonte e Koxhaj, ku ka ngel projekti, që nuk është përfunduar.

4. Të çështja e prerjes dhe dëmtimit të pyjeve, pyjet, e tha edhe znj. Hafize Sallahu se gjendja e pyjeve në malet e Sharrit është alarmante e prerjes dhe dëmtimit të pyjeve në mënyrë të pa mëshirshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkesa të tjera nuk ka, besoj përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës, ndërkaq konstatoj me kaluar në pikët vijuese sipas rendit të punës;

2. Propozim Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre;

Kryesuesi i Kuvendit, Kërkesa ka qenë e kahershme për me pasur një Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Drejtoria e ka marrë parasysh kërkesën tonë dhe ka dalë me një draft rregullore të cilën na e ka sjellë këtu në KK. Draft Rregullorja është shqyrtuar në KPF dhe në atë mbledhje KPF është vendosur të hiqet pika 3 e nenit 20 në bazë të propozimit të Ekrem Kyçyku. Për sqarime të nevojshme në Draft Rregullore, fjalën e ka drejtori i DSHPE, z. Ramadush Osmani.

z. Ramadush Osmani, Drafti Rregullorja është pak sa unike në tërë Republikën e Kosovës. Drafti na është ofruar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, ndërkaq ne DSHPE kemi formuar një komision i cili është marrë me përpunimin e Rregullores në fjalë.

Jemi munduar që Draft Rregulloren me ia përshtatur specifikave të komunës tonë, duke bërë një unifikim të varrezave për tërë komunën. Në këtë draft është përcaktuar madhësia e varrezave, gjerësia, lartësia sipas planeve të caktuara komunale, organi kompetent për varreza publike dhe ato të veçanta (dëshmorëve, etj.), veprimet e ndaluara si dhe gjobat për shkeljen e dispozitave të saj.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Adnan Reka, Edhe ne takimin e Komitetit për Shërbime Publike kemi thënë se kjo Draft Rregullore ka shumë mangësi, por megjithatë, jemi pajtuar që me mirë të jetë një rregullore jo e mirë, se sa të mos ketë fare.

Unë them që është shumë e përgjithësuar, dhe se duhet të jetë me e saktësuar! Duhet të thuhet që, KBF apo Ndërmarrja e specializuar është përgjegjëse për mirëmbajtjen e varrezave dhe do të kryej këto shërbime: dhe të dihen saktë cilat janë ato shërbimet që do të kryej kjo ndërmarrje.

Të neni 16, pika 2.8 -Për vendosjen e pllakave përkujtimore ose përmendoreve, duhet të paraqitet Kërkesë e veçantë në KBF, me skicën e objektit, respektivisht përmendores. (Me sa di unë, ne jemi shtet laik dhe neutral ndaj feve, prandaj kërkesa për vendosjen e pllakave përkujtimore, përmendoreve apo lejet për ndërhyrje në varreza duhet të merren vetëm nga DSHPE, si organ shtetëror, e jo nga KBF. KBF mund të jetë për shërbesa, por jo edhe të lëshoj leje për kërkesa të tilla),

Të neni 23 bartjen e kufomave në territorin e komunës e bënë KBF-ja, ndërmarrja publike e specializuar komunale ose ndërmarrja tjetër e specializuar e kontraktuar për këtë qëllim apo nga ana e vetë familjarëve (pse të mos thuhet, të gjitha shërbimet e ceremonisë së varrimit i bënë KBF-ja, meqë edhe ashtu KBF paguhet nga 150€ për çdo person të vdekur, e që besoj se nuk janë pak, marrë parasysh standardin e jetesës në vend).

znj. Nazife Krasniqi, E përshëndes drejtorin e drejtorisë për një punë të mirë që e ka bërë, ndërkaq unë mendoj se duhet të bëhet edhe një Kontejner për pajisje të nevojshme për varrim dhe me i pagur dy punëtorë për hapjen e varrit. Kjo formë po aplikohet edhe në vendet tjera. Çështja e hapjes së varrit duhet të u negociuar me kompaninë që po i kryen shërbimet e varrimit, sepse marrëveshja ka nevojë për rishqyrtim.

z. Ekrem Raka, Të neni 9.5, pasues, duhet të behët sipas riteve fetare “por jo më shumë së 0.80m” duhet të hiqet, pasi Kosova është shtet laik dhe nuk e di sa mund t’i kufizojmë dimensionet e mbulesës së varrit mbi kufomë, sepse nuk e dimë sesi e kanë të përcaktuar këtë çështje ritet tjera fetare.

znj. Afërdita Shehi, Është mirë që të Varrezat e dëshmorëve me u vendosur një farë cerade, dhe aty me u shitur lule dhe me lënë pajisjet e nevojshme për mirëmbajtjen e varrezave.

Kryesuesi i Kuvendit, Është mirë që po bëhet kjo Rregullore, rregullorja si duket i trajton mirë çështjet. Për lapidarët që u potencua, me këtë merret drejtorja e Urbanizmit, ndërkaq për me gjerë, merret Kuvendi i Komunës. Çështjen të cilën e ngriti z. Ekrem Raka, sa duhet të jetë varreza mbi tokë e mbuluar me dhe, propozimi i tij është i arsyeshme, ndërkaq disa çështje teknike të cilat u potencuan, mundet me u rregulluar me vendime. Të rishqyrtimi i Kontratës me Bashkësinë Islame, kjo ka qenë edhe Kërkesë e z. Selim Reka dhe ka nevojë kontrata të rishqyrtohet, sepse duhet të hynë në kontratë edhe bartja e kufomës dhe hapja e varrit. Në këtë drejtim, është mirë me punuar më tepër KSHP në bashkëpunim me DSHPE, t’i diskutoni këto gjëra, na i sjellin në KK një formulim të ri të Propozim Vendimit dhe besoj se do të aprovohet nga Kuvendi i Komunës.

z. Ramadush Osmani, Pajtohem me atë që kjo rregullore nuk është perfektë, ndërkaq arsyeja pse e kemi futur në KBF me u futur në rregullore, sepse rregullorja është e përgjithshme komunale dhe ka të bëjë me të gjitha fetë, komunitetet dhe të gjitha vendvarrimet. Ne kemi në çdo fshat vendvarrime dhe drejtorja e ka të pamundur të mirëmban të gjitha varrezat, nëse nuk do të ishin, Këshillat e Bashkësive Fetare, kështu kur përcaktohet një organ për mirëmbajtjen e tyre, ai organ e merr edhe përgjegjësinë për mirëmbajtjen e tyre, në bazë të lejes që e lëshon komuna.

Të përmendoret, këtu është potencuar të varrezat publike të cilat janë të karakterit të veçantë, si varrezat e dëshmorëve, të luftëtarëve, viktimave civile, ndërkaq organi që merret me to është DSHPE. Të neni 2, pika 1.8 ka të bëjë me rregullimet të cilat bëhen në varrime publike, të bëhet një skicë për unifikim të varrezave, në mënyrë që mos të bëhen laramani të rregullimit të varrezave. Në këtë rast, nëse në të ardhmen mendojmë me ia dhënë një

kompanie me tender apo KBF, kështu që dihet se si duhet të jetë forma dhe përmbajtja e varrezave.

Sa i përket bartjes së kufomës dhe hapjes së varrit, këto nuk janë futur në rregullore, sepse duhet të bëhen me vendim të veçantë.

Të neni 9.5 mund të lëmë atë që e tha Ekrem Raka, sepse nuk e di si e kanë të paraparë këtë ritet tjera fetare. Të pyetja e znj. Nazife, ai që e merr tenderin, duhet të dijë se çka përmban krejt kontrata dhe forma e mirëmbajtjes, d.m.th. këto rregullohen me kontratë.

Kryesuesi i Kuvendit, Të propozimi i Ekrem Raka, pasuesi 9.5, pas pasuesit sipas riteve fetare, hiqet pasuesi “por jo me shumë së 0.80 m” dhe të nenit 20 hiqet pika 3. Me këto dy ndryshime, Propozim Rregulloren e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre / Lënda: 01 Nr. 07-104/01-34317/18.

3. Propozim- Vendim për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës për vitin 2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Selim Reka, Në emër të LDK e konfirmoj se përkrahim këtë Propozim Vendim, sepse me mirë të ridestinohen mjetet buxhetore sesa të kthehen në qeveri, ndërkaq në të ardhmen është mirë të bëhen edhe ridestime të tjera nëse ngelin mjete buxhetore, sepse ka nevoja ku mund të shkojnë mjetet e ngelura që ngelin të pashpenzuara.

Kryesuesi i Kuvendit, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u miratua me 5 votë Abstenime nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për rregullimin e ndarjeve buxhetore të Komunës për vitin 2018 / Lënda: 01Nr. 400/01-34711/18.

4. Propozim Vendimi për dhënie në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcelën kadastrale Nr. 00587-2, ZK në Kaçanik, Agjencionit të punësimit të Republikës së Kosovës;

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku nuk është prezent këtu prezent për shkak të disa angazhimeve të tjera të tij, kështu po I jap disa sqarime të nevojshme unë. Këtu bëhet fjalë për dhënie e një prone në shfrytëzim afatëgjatë, MPMS – Agjencionit të Punësimit për 99 vjet. Ata kanë kërkuar që ne më ua dhënë pronën në shfrytëzim, për ndërtimin e Entit të Punësimit. ndërkaq ndërtimin e objektit e bëjnë ata vet. Nëse keni nevojë për sqarime shtesë, do të jap zyrtari i Kadastrit, Hamzë Berisha. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Pyeti për parcelën e kërkuar nga Agjencia e Punësimit për ndërtimin e Zyrës së punësimit, ku gjendet ajo pronë?

z. Hamzë Berisha- Zyrtaar në Sektorin e Kadastrit, Theksoj se lokacioni I kërkuar nga Agjencia është afër Tregut të kafshëve ku ka qenë më herët. Çështja e dhënies në shfrytëzim të pronës në rastet kur e kërkon institucioni, është e rregulluar në mënyrë decisive me Ligjin mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave.

z. Ekrem Raka, A është hapësira e mjaftueshme në atë lokacion ku parashihet të ndërtohet Zyra e Punësimit, sepse në atë pjesë sa i di unë, kohëve të fundit janë bërë shumë ndërtime?

Kryesuesi i Kuvendit, Besoj se hapësira është e mjaftueshme për sipërfaqen e kërkuar nga Agjencia për Punësim. Prona është komunale, nuk epet në shfrytëzim personave privat, por institucionit. E sqaroj Hamza edhe anën ligjore se procedura nuk shkon përmes Ankandit Publik, por shkon direkt me Vendim të Kuvendit të Komunës.

z. Bekim Koxha, A do të jepet ajo pronë në shfrytëzim vetëm për ndërtimin e Zyrës së punësimit ?

z. Shpend Krusha, Me ndërtimin e Zyrës së punësimit, a do të hapet ndonjë vend i ri i punës?

Kryesuesi i Kuvendit, Në atë pronë do të ndërtohet vetëm Zyra e Punësimit, ndërkaq vende të reja të punës nuk ka sepse punëtorët veç ekzistojnë të Zyrës së punësimit. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë,

VENDIM

Për dhënien në shfrytëzim afatëgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, parcelën kadastrale Nr. 00587-2, ZK në Kaçanik, Agjencionit të punësimit të Republikës së Kosovës / Lënda: 01Nr. 104/02-34197/18.

5. Propozim Vendim për Themelimin e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;

Kryesuesi i Kuvendit, Në bazë të LVL dhe Statutit të Komunës si dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL- Për procedurën e themelimit e Komiteteve Konsultative, me Kërkesë të Handikos, kam propozuar të themelojmë Komitetin Konsultativ të personave me aftësi të kufizuara. Një Komitet të tillë e kanë formuar të gjitha komunat. Ne kemi nevojë edhe për themelimin e Komiteteve të tjera konsultative të cilat janë në shërbim të qytetarëve. Rëndësia e themelimit të Komiteteve Konsultative është që, t'iu epet mundësia qytetarëve nga jashtë që të jenë pjesë e proceseve të komunës. Në këtë vendim e kemi paraparë edhe themelimin e Komitetit Konsultativ edhe formimin e panelit në përbërje. 5 anëtarëve, me përfaqësim si vijon: 3 nga KK, 1 nga Ekzekutivi dhe 1 nga OJQ.

Përbërja e këtij komiteti duhet të jetë: 5 deri në 7 anëtarë. Për përbërjen e Komitetit Konsultativ, kërkoj mendimin e shefave të grupeve parlamentare se a jeni që ky komitet të jetë në përbërje 5 apo 7 anëtarë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Bekim Koxha, Propozoj që përbërja e këtij komiteti të jetë prej, 7 anëtarëve.

z. Ekrem Kycyku, Propozoj që përbërja e këtij komiteti të jetë prej, 5 anëtarë.

z. Selim Reka, Propozoj që përbërja e këtij komiteti të jetë prej 7 anëtarë, pasi që edhe Komitetet tjera janë në përbërja 7 anëtarë, kështu mos të bëjmë diskriminim në këtë rast.

z. Shemsedin Luzha, Edhe subjekti politik i AAK propozojmë që përbërja e këtij komiteti të jetë prej 7 anëtarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, Edhe unë mendoj që përfshirja me e madhe në këtë komitet i kontribuon edhe më shumë çështjes për të cilën themelohet. Atëherë, shkojmë me propozime konkrete për zgjedhjen e panelit, 3 anëtarë duhet të jenë nga KK, 1 nga ekzekutivi me konkretisht nga Zyra e personalit dhe 1 anëtar nga OJQ. Atëherë nga tri grupet parlamentare me të mëdha kërkojmë propozimet konkrete (PDK, LVV dhe LDK) për anëtarë të panelit:

Nga PDK, z. Nexhat Loku, E propozoj për anëtar të panelit, z. Ahmet Luma,

Nga LVV, z. Ekrem Kyçyku, e propozoj të jetë anëtare e panelit, znj. Kaltrina Tafili.

Nga LDK, Selim Reka e propozoj për anëtare të panelit, znj. Arlinda Rakoci-Raka.

Propozimin për themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në përbërje prej 7 anëtarëve dhe formimin e panelit në përbërje prej 5 anëtarëve me emrat e propozuar, e shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u miratuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në përbërje 7 anëtarë.

Paneli që do të merret me procedurat e zgjedhjes së këtij komiteti, është në përbërje prej 5 anëtarëve dhe atë:

1. Ahmet Luma, nga PDK,
2. Kaltrina Tafili nga LVV dhe
3. Arlinda Rakoci-Raka nga LDK.
4. Një përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës, caktohet nga Kryetari i Komunës dhe
5. Një përfaqësues nga OJQ-të. / Lënda: 01 Nr. 104/02-34370/18.

6. Informatë për përfundimin e vitit shkollor, 2017/2018;

Kryesuesi i Kuvendit, Për këtë pikë fjalën e ka drejtori i DAK, Zahir Doda.

z. Zahir Doda, Theksoj se Informatën e keni marrë me kohë, janë paraqitur statistikat për periudhën e caktuar, e cila periudhë veç ka kaluar. Në material është paraqitur gjendja reale e vitit shkollor 2017/2018. Informata është sa për njoftimin tuaj, sepse informatë nuk del në votim. Unë i marrë parasysh rekomandimet e juaja në këtë informatë dhe ua përcjell shkollave. Kjo pikë është shqyrtuar edhe në KPF, ndërkaq shqetësimet e mia janë mungesat e mëdha të arsimtarëve dhe të nxënësve, ndërkaq do të mundohem me gjetur forma për uljen e tyre, duke zbatuar edhe rregulloren e cila është miratuar në KK. Çdo vërejtje apo ndonjë lëshim nëse është vërejtur apo rekomandime të juaja janë të mirëpritura nga ana ime.

Kryesuesi i Kuvendit, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

z. Ekrem Raka, Nga statistikat e paraqitura si në materialin e informatës, numri i madh i mungesave të mësimdhënësve është shqetësuese. Në këtë rast përgjegjësia kujtoj së bie edhe të menaxherët e shkollave, por edhe të drejtori i DAK.

z. Adnan Reka, Faleminderit për informacionin drejtor! Megjithëse statistikat janë statistika dhe shpeshherë gjendja faktike mund të jete me ndryshe nëpër shkolla, unë kam disa pyetje dhe komente:

Për gjendjen e shkollës në Kovacec besoj se të gjithë jeni në dijeni, mendoj që nuk do t'i pëlqente askujt të nxjerrja statistika (së paku) 6 mujore të fëmijëve që kanë pësuar lëndime të ndryshme në shkollë deri në thyerje të kockave të trupit, si pasojë e gjendjes jashtëzakonisht të keqe në ambientet e shkollës. Po të bëhej një film i metrazhit të shkurtër gjatë orës së edukatës fizike, pak kush, do të besonte se ky film është bërë diku në Evropë, të gjithë do të besonin se fjala është për Afganistan apo ndonjë shtet Afrikan, po të mos ishin fëmijët ata që do të bënin diferencën;

- Pyetja është, edhe sa fëmijë duhet të pësojnë lëndime fizike apo sëmundje epidemike në këto ambiente shkollore deri sa të kuptojmë se kujt duhet t'i jepet tenderi për ndërtimin e një shkolle.

- Për shkollën 'Emin Duraku' besoj që jeni në dijeni së ende nuk është realizuar renovimi i sallës së edukatës fizike, dhe fëmijët pothuajse janë të privuar nga lënda me e dashur e tyre. A ka gjasa që kjo sallë të rinovohet ndonjëherë dhe të ndërpritet kundërmimi nëpër korridorin e shkollës? Së paku djali im pas 40 viteve të jetë në gjendje të mësoj në kushte të përafërta me babin e tij, sepse gjendja aktuale është paradoksale!

z. Bekim Koxha, Theksoj se Kuvendi i Komunës ka numër të madh të arsimtarëve të cilët për me marrë pjesë në mbledhje të KK mund t'i humbin orët e mësimi. Me intereson të di, a marrin leje këta arsimtarë kur kanë mbledhje të Kuvendit të Komunës apo të trupave punuese të KK dhe a i japin llogari ndokujt për mungesat e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, LVL, e përcakton decidivisht se secili punëdhënës është i obliguar që për seanca të KK dhe të trupave punues të KK të iu jap leje anëtarëve të KK të marrin pjesë në seancë. Këtë përgjigje ia mora drejtorit të DAK, megjithëse kujtoj se nuk ka problem.

z. Selim Reka, Raporti është shumë reale, ajo që është pozitive është rezultati në testin e maturës në Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik. Suksesi në shkolla shihet se është pak i fryrë e sidomos në shkollat fillore, sepse kjo po vërtetohet në shkolla të mesme kur po vijnë nxënësit. Është mirë që të rekomandohet që mos të jenë dorëlibër shkollat në rritjen e notave të nxënësve.

Edhe pse është investuar në disa shkolla, duhet bërë ende në këtë drejtim ashtu që të krijohet një ambient i jashtëm dhe i brendshëm i kushteve në shkolla, siç u përmend nga z. Adnan Reka, të investohet në salla të edukatës fizike në shkolla.

Numri i nxënësve është shqetësues, ndërsa dihet disa nga mungesat e arsyeshme se si krijohen, si; çështja e trajnimeve të arsimtarëve, sëmundje, vdekje e të afërme të tyre, etj. Pavarësisht kësaj ka mundësi sadopak me u ulur e mungesave të arsimtarëve në saje të zbatimit të rregullores të cilën e kemi miratuar.

znj. Hafize Sallahi, Më intereson të di në SHMP nxënësit a janë të obliguar të përcaktojnë vet ditën së kur do të mbajnë praktikën, sepse në vitin e kaluar ka pasur raste kur nxënësit në saje të punës praktike kanë pasur nga tri ditë pushim. Praktikën e kanë rolin e vet, nxënësit e asaj shkolle kanë kycje me tregun, nëse është nevoja edhe në biznese private.

z. Zahir Doda, Disa çështje të cilat u ngritën në kuadër të informatës , do të iu përgjigjem me shkrim. Të z. Adnan Reka, e bëri një përshkrim të gjendjes në shkollë, unë mendoj se Adnani si punëtor arsimit nuk i takon me bërë këtë përshkrim, përshkrimin e gjendjes në shkollë duhet ta bëjë dikush tjetër. Të çështja e drejtorit, është marrë masa e pezullimit, kjo është e rregulluar me ligj. Të orët e humbura, disa orë zëvendësohen, nuk kam përgjigje të rregullt.

z. Adnan Reka, Ne fillim të këtij muaji kuptuam që drejtori i shkollës në fshatin Doganaj e kishte rrahur një nxënës, meqë prindi i nxënësit e kishte raportuar në Polici, drejtori me pas e kishte rrahur edhe prindin dhe si pasojë drejtori kishte përfunduar në burg shtëpiak. Cilat janë hapat që keni marrë apo keni planifikuar të merrni për këtë veprim të shëmtuar dhe fare jo profesionist.

Kryesuesi i Kuvendit, Lidhur me pyetjen e z. Adnan Reka, për çështjen e drejtorit të SHF në Doganaj, janë organet kompetente që merren me këtë punë.

z. Bekim Koxha, Është shqetësuese për drejtorin e shkollës fillore të f. Doganaj për veprimet e tilla., por janë organet kompetente që merren me rastin.

Kryesuesi i Kuvendit, Diçka tjetër për këtë pikë nuk ka, andaj konstatoj se Kuvendi i Komunës, përmes materialit- **Informatës së DAK, u Njoftua për aktivitetin e shkollave për përfundimin e vitit shkollor , 2017/2018.**

7. Informatë – Përmbledhja e rezultateve për vitin 2017, për Grantin e performancës-Komuna Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit, Theksoj se MAPL për çdo vit bënë matjen e performancës së Komunave të Kosovës. Sivjet jemi në radhën e 5 komunave me performancë më të mirë. KK është vlerësuar me performancën më të mirë me pikë maksimale, vetëm me minus 3 pikë për Raportin e Auditorit të Brendshëm. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:


z. Shpend Krusha, Me intereson të di se ku do të shpenzohen mjetet e fituara të komunës nga Granti i performancës.

z. Selim Reka, Është mirë që është Komuna e Kaçanikut që ka fituar këtë grant në bazë të arritura në aktivitetin e shërbimeve, ndërkaq nuk duhet të ndalemi me kaq. Në të ardhmen duhet punohet edhe më tutje, në mënyrë që të arrihen rezultate edhe me të mira.

Kryesuesi i Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit, Sa i përket pyetjes së Shpend Krusha për shpenzimin e mjeteve nga granti i performancës, do të vendoset me Vendime të Kuvendit të Komunës. Diçka tjetër për këtë pikë nuk ka, andaj konstatoj se Kuvendi i Komunës, u **Njoftua me aktivitetin e komunës në bazë të materiali të Informatës- Përmbledhja e rezultateve për vitin 2017, për Grantin e performancës së Komunës.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:16 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu




Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e X (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2018, mbajtur me 30 . 10. 2018.

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma
4. Kadri Krivenjeva,.....
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,